



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTVENDIM

Nr. 18327, datë 22. 10 2025

PËR

“ MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIT TË QIRASË, TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 2 pika 36 dhe nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Vendimin nr. 18517/1 prot., datë 20.10.2025 të Komisionit të Strehimit, për “Miratimin e e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, vlera të cilat do të zbatohen në programin e subvencionit të qirasë për vitin 2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025, si më poshtë vijon:
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 1+1, është 18 250 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 2+1, është 25 100 (njëzetë e pesë mijë e njëqind) lekë.
 - Qiraja mesatare për strukturën e apartamentit 3+1, është 30 700 (tridhjetë mijë e shtatëqind) lekë.
2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë, sipas vlerave të paraqitura në këtë projektvendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 18327/ Prot.

Lezhë, me 22.10.2025

Lënda: Relacion për projektvendimin për “Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

KËTU

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 2 pika 36 dhe nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a VKM nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”. Në kuadër të këtyre detyrimeve dhe me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim, përmes programit të subvencionit të qirasë, si një instrument i programit të banesave sociale me qira i cili ndihmon individët/familjet të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohen me vendim të këshillit bashkiak, vlerat mesatare të qirasë në treg të lirë, ku këto vlera mesatare do të jenë vlerat maksimale e subvencionit të qirasë, sipas nenit 38 pika 1 e ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar. Bazuar në VKM-në nr. 362, datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, pika 4/a shprehet se, për përcaktimin e vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë, duhet ndër të tjera të përcaktohet dhe vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë nga njësitë e qeverisjes vendore. Sa më sipër, për të realizuar vlerat e tregut janë kontaktuar disa operatorë të regjistruar pranë organeve tatimore si subjekte që ofrojnë shërbime imobilare, ku pesë prej tyre kanë dërguar të dhëna mesatare mbi qiratë e apartamenteve sipas strukturave përkatëse, konkretisht për strukturën e apartamenti 1+1, strukturën e apartamenti 2+1 dhe strukturën e apartamenti 3+1. Sa i përket vlerave të strukturës së apartamentit garsonierë, për Bashkinë Lezhë kjo vlerë është paraqitur në mungesë nga agjensitë imobilare, pasi nuk ka banesa garsoniere me qira në Lezhë. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barazvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë, sipas vlerave të paraqitura në këtë projektvendim. Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, ka përgatitur relacionin Nr. 18157 prot., datë 20.10.2025 “Relacion përmbledhës mbi llogaritjen e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, bazuar në të dhënat e marra nga agjensitë imobilare Lezhë, për programin e subvencionit të qirasë, të cilën e ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Komisionit të Strehimit, në Bashkinë Lezhë. Komisioni Strehimit i ngritur me vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë dhe bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të vlerave të agjensive imobilare, mori vendimin Nr. 18157/1 prot., datë 20.10.2025 për “Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë, të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, vlera të cilat do të merren për zbatim në programin e subvencionit të qirasë për vitin 2026. Këto vlera mesatare do të parashikohen vetëm për ato familje të cilat akoma nuk kanë depozituar pranë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dhe si maksimum i subvencionit të qirasë, për ato familje që i kanë vlerat më të larta në kontratën e qirasë.

Në bazë të këtij informacioni, janë llogaritur vlerat mesatare të qirave për territorin e Bashkisë Lezhë për vitin 2025, sipas strukturave të apartamenteve, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë, nga agjensia	Çmimi në lekë, nga agjensia	Çmimi në lekë, nga agjensia	Çmimi në lekë, nga agjensia	Çmimi në lekë, nga agjensia	Çmimi mesatar në lekë
				“Lezha Real Estate”	“LC Lorena Company”	“Agjensi Imobiliare Ndreca”	“RE/MAX LISUS”	“SL Real Estate”	
1	Banesë me qira (apartament 1+1)	1 muaj	1	18 000	19 000	17 500	17 500	19 250	18 250
2	Banesë me qira (apartament 2+1)	1 muaj	1	27 500	19 750	26 500	25 250	26 500	25 100
3	Banesë me qira (apartament 3+1)	1 muaj	1	32 500	25 000	34 000	29 500	32 500	30 700

Në këto kushte, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, paraqesim për miratim këtë projektvendim për “Miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2025”, vlera të cilat do të përdoret për zbatimin e programit të subvencionit të qirasë, për vitin 2026.

Drejtori i Shërbimit dhe Kujdesit Social

Marte Fetaj

KRYETARI
Pjerin Ndreu

